

Tabela 3

DIREKTIVA 2014/40/BE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KESHILLIT e datës 3 Prill 2014 Mbi përafrimin e ligjit, rregullave dhe dispozitat administrative të shteteve anëtare rreth prodhimit, prezantimit dhe shitjes së duhanit dhe produkteve të duhanit dhe shfuqizimi i Direktivës 2001/37/KE Gazeta Zyrtare e Komunitetit Europian, L 127/1, 29.4.2014		Legjislacioni shqiptar i propozuar: Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit Shkalla e përafrimit (një nga tre mundësitë e mëposhtme) në total e projekt-aktit Përputhshmëri e plotë Përputhshmëri e pjesshme I papërputhur				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
2(4)	Produkte duhani, nënkupton produkte që mund të konsumohen dhe përmbajnë, qoftë dhe pjesërisht duhan, të modifikuar gjenetikisht ose jo	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit”.	Neni 1/Pika 1(1)	Produkte duhani, nënkupton produkte që mund të konsumohen dhe përmbajnë, qoftë dhe pjesërisht duhan, të modifikuar gjenetikisht ose jo	E plote	
2 (10)	Cigare nënkupton mbështjellje duhani e cila mund të konsumohet nëpërmjet një procesi djegie i përkufizuar më tej në artikullin 3(1).	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit”.	Neni 1/Pika 3 (19)	Cigare nënkupton një mbështjellje duhani të grirë e cila konsumohet nëpërmjet procesit të djegies, përveç purove, cigarillove dhe mbështjelljeve të tjera të duhanit	E pjesshme	
2 (2)	Duhan për llullë nënkupton duhanin qe digjet dhe pihet me llullë.		Neni1/Pika 3 (21)	Duhan për llullë nënkupton duhanin e grirë trashë, për pirje me llullë	E pjesshme	

2 (8)	Duhan për përdorim oral nënkupton të gjitha produktet e duhanit për përdorim oral me përjashtim të atyre produkteve që janë për t'u thithur me hundë apo për përthypje, të prodhuara tërësisht ose pjesërisht prej duhanit, në forme pluhuri, grimcash apo të kombinuara së bashku, që pakëtohen në qeska poroze.	Ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.	Neni 1/Pika 3 (25)	Duhan për përdorim oral nënkupton të gjitha produktet e duhanit për përdorim oral me përjashtim të atyre produkteve që janë për t'u thithur me hundë apo për përthypje, të prodhuara tërësisht ose pjesërisht prej duhanit, në forme pluhuri, grimcash apo të kombinuara së bashku, që pakëtohen në qeska poroze.”	E plotë	
2 (5)	Duhan pa tym nënkupton një produkt duhani që nuk digjet, duke përfshirë duhanin për përthypje, duhanin për thithje me hundë dhe duhanin për përdorim oral.	Ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.	Neni 1/Pika 3 (26)	Duhan pa tym, nënkupton një produkt duhani që nuk digjet, duke përfshirë duhanin për përthypje, duhanin për thithje me hundë, duhanin për përdorim oral dhe duhanin me ngrohje	E plotë	
2 (14)	Produktet e reja të duhanit nënkuptojnë produktet e duhanit që (a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t'u dredhur, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përthypje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja dhe (b) vendosen në treg pas dates 19 Maj 2014	Ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.	Neni 1/Pika 3 (29)	Produktet e reja të duhanit nënkuptojnë produktet e duhanit që (a) nuk bëjnë pjesë në asnjë nga kategoritë e mëposhtme si: cigare, duhan kaush/për t'u dredhur, duhan për nargjile, puro, cigarillo, duhan për përthypje, duhan për thithje me hundë, duhan për përdorim nga goja dhe (b) vendosen në treg pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.	E plotë	
2 (16)	Cigare elektronike nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pjese që	Ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga	Neni 1/Pika 3 (30)	Cigare elektronike nënkupton një produkt që mund të përdoret për konsum të avullit që përmban nikotinë me anë të një pjese që	E plotë	

	vendoset pranë gojës, ose çdo përbërës tjetër i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një pajisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë një përdorimshe ose me rimbushje me anë të një ene për rimbushje dhe një depozite, ose mund të rikarikohet me një mbajtëse njëpërdorimshe.	produktet e duhanit”.		vendoset pranë gojës, ose çdo përbërës tjetër i atij produkti, duke përfshirë një mbajtëse, një depozitë dhe një pajisje pa mbajtëse ose depozitë. Cigaret elektronike mund të jenë një përdorimshe ose me rimbushje me anë të një ene për rimbushje dhe një depozite, ose mund të rikarikohet me një mbajtëse njëpërdorimshe.		
2 (17)	Enë rimbushëse nënkupton një pajisje që mban një lëng me përmbajtje nikotine, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit”	Neni 1/Pika 3 (31)	Enë rimbushëse nënkupton një pajisje që mban një lëng me përmbajtje nikotine, e cila mund të përdoret për rimbushje të një cigareje elektronike.	E plotë	
2 (25)	Shije karakteristike nënkupton një shije apo erë të dallueshme e ndryshme nga ajo e duhanit, si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë duke përfshirë, por pa u limituar në: fruta, barishte, alkol, sheqerëra, mentol ose vanilje; të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit”	Neni 1/Pika 3 (33)	Shije karakteristike, nënkupton një shije apo aromë qartësisht të dallueshme, e ndryshme nga ajo e duhanit, si rezultat i përdorimit të një lënde shtesë apo i një kombinimi lëndësh shtesë duke përfshirë, por pa u kufizuar në: fruta, erëza, barishte, alkol, karamelë, mentol ose vanilje; të cilat janë të kuptueshme para ose gjatë konsumit të produkteve të duhanit.	E plotë	
2 (12)	Cigarillo nënkupton një lloj të vogël cigareje dhe është e specifikuar më tej në nenin 8(1) të direktivës së	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit	Neni 1 /Pika 3 (34)	Cigarillo, nënkupton një lloj puro me peshë jo më të madhe	E plotë	Specifikimet për peshën e produktit janë

	këshillit 2007/74/BE (2);	nga produktet e duhanit		se 3 gram.		marrë nga neni 8 i direktivës 2007/74/BE, siç citohet në përkufizimin e direktivës 2014/40/BE
2 (23)	Substancë shtesë, nënkupton një substancë të ndryshme nga duhani e cila i shtohet një produkti duhani, një njësie pakete ose çdo paketimi të jashtëm	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 1/ Pika 3 (35)	Substancë shtesë, nënkupton një substancë të ndryshme nga duhani e cila i shtohet një produkti duhani, një njësie pakete ose çdo paketimi të jashtëm	E plotë	
2 (24)	Aromatizues, nënkupton një substancë shtesë e cila mundëon aromë dhe/ose shije	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 1/ Pika 3 (36)	Aromatizues, nënkupton një substancë shtesë e cila mundëon aromë dhe/ose shije	E plotë	
20 (4) a	Shtetet Anëtare do të sigurojnë që cigaret elektronike dhe enët rimbushëse përfshijnë një fletëpalosje me informacione për: (i) udhëzimet për përdorimin dhe ruajtjen e produktit, duke përfshirë një referencë që produkti nuk rekomandohet për përdorim nga të rinjtë dhe jo-duhanpirësit; (ii) kundërrindikacionet e përdorimit; (iii) paralajmërimet për grupet e veçanta të riskut, (iv)	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 2/Pika 4	Çdo njësi paketimi e cigareve elektronike dhe paketim i rimbushjeve të lëngut të nikotinës duhet të përmbajë një fletë informuese në gjuhën shqipe ku të përfshihet informacion rreth: instruksioneve të përdorimit dhe magazinimit të produktit duke përfshirë dhe një referencë që ky produkt nuk rekomandohet të përdoret nga të rinjtë dhe nga joduhanpirësit;	E plotë	Fjalja është përshtatur në një mënyrë që mund të kuptohet më lehtë në kontekstin e ligjit shqiptar. Është saktësuar nevoja që fleta informuese të

	paralajmërimet për efektet anësore; (v) shkallën e varësisë dhe toksicitetit; dhe detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit dhe kontaktet e një personi ligjor ose natyror brenda bashkimit.			kundërindikacionet e përdorimit; paralajmërimet për grupet e veçanta të riskut, paralajmërimet për efektet anësore; shkallën e varësisë dhe toksicitetit; dhe detajet e kontaktit të prodhuesit ose importuesit.		jetë në gjuhën shqipe.
20 (3) a	Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtëseve të dedikuara për rimbushje me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike një përdorimshe me volum jo më shumë se 2 ml.	Ligji “Për mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 2/Pika 5	Lëngu me përmbajtje nikotine vendoset në treg vetëm kur është në mbajtëseve të dedikuara për rimbushje me volum jo më shumë se 10 ml ose në formën e cigareve elektronike një përdorimshe me volum jo më shumë se 2 ml.	E plotë	Fjalja është përshtatur në një mënyrë që mund të kuptohet më lehtë në kontekstin e ligjit shqiptar. Kjo është arsyeja pse fjalja nuk përputhet me versionin anglisht të kur përkthehet nga anglishtja në shqip.
20 (3) b	Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20mg/ml nikotinë	Ligji “Për mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 2/Pika 6	Nuk lejohet vendosja në treg e lëngut që përmban më shumë se 20mg/ml nikotinë	E plotë	
19 (1)	Shtetet anëtare i kërkojnë prodhuesit dhe importuesit të produkteve të reja të duhanit të paraqesin një njoftim autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare të çdo produkti të duhanit	Ligji “Për mbrojtjen e shendetit nga	Neni 3	Prodhuesit dhe/ose importuesit e produkteve të reja të duhanit, përfshirë cigaret elektronike dhe duhanin me ngrohje, janë të detyruar të njoftojnë Ministrinë	E pjesshme	Fjalja është përshtatur në një mënyrë që mund të kuptohet më lehtë në

	që ata synojnë të vendosin në tregun kombëtar në fjalë. Ky njoftim duhet të dorëzohet në formë elektronike gjashtë muaj përpara vendosjes së planifikuar në treg. Do të jetë i shoqëruar nga një përshkrim i hollësishëm i produktit të ri të duhanit në fjalë, si dhe udhëzimet për përdorimin e tij dhe informacion mbi përbërësit dhe emetimet në përputhje me nenin 5: Prodhuesit dhe importuesit duhet të dorëzojnë një njoftim për një produkt të ri të duhanit dhe gjithashtu t'u sigurojnë autoriteteve kompetente: (a) studime shkencore në dispozicion mbi toksicitetin, varësinë dhe atraktivitetin e produktit të ri të duhanit, vecanërisht përsa i përket përbërësve të tij dhe emetimeve; (b) studimet që janë në dispozicion, përmbledhjet ekzekutive të tyre dhe hulumtime të tregut mbi preferencat e grupeve të ndryshme të konsumatorëve, duke përfshirë të rinjtë dhe duhanpirësit aktual; (c) informacione të tjera të disponueshme dhe relevante, duke përfshirë një analizë risk/përfitim të produktit, efektet e pritshme të tij	produktet e duhanit		përgjegjëse për Shëndetësinë, për produktet e reja të duhanit. Ky lajmërim duhet dorëzuar në formë elektronike, jo më vonë se 30 ditë para hedhjes në treg të produktit. Njoftimi duhet të përmbajë: a. informacion kontakti të prodhuesit ose importuesit në Shqipëri; b. një përshkrim i detajuar i produktit, c. instruksionet e lidhura me përdorimin e tij, d. listën e përbërësve të produktit, e. materialet e disponueshme të kërkimeve shkencore, rrezikun e varësisë dhe tërheqjen e produktit.”		kontekstin e ligjit shqiptar. Sqarime të mëtejshme siç specifikohet në direktivë mund të specifikohen në akte të tjera nënligjore
--	---	---------------------	--	--	--	---

	mbi ndërprerjen e konsumit të duhanit, efektet e tij të pritshme mbi fillimin e konsumit të duhanit dhe perceptimi i parashikuar i konsumatorit.					
7 (1)	Shtetet Anëtare ndalojnë vendosjen në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Shtetet Anëtare nuk do të ndalojnë përdorimin e aditivëve që janë esenciale për prodhimin e produkteve të duhanit, si për shembull sheqer për të zëvendësuar sheqerin që humbet gjatë procesit të shërimit, me kusht që këto shtesa most ë rezultojnë në një product me një aromë karakteristike dhe nuk rrit në një shkallë të konsiderueshme ose të matshme varësinë, toksicitetin ose vetitë CMR të produktit të duhanit. Shtetet Anëtare do të njoftojnë Komisionin për masat e marra sipas këtij paragrafi.	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 6 paragrafi 1	“Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit me shije karakteristike. Nuk ndalohet përdorimi i substancave shtesë të cilat janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të duhanit si përshembull përdorimi i sheqernave që zëvendësojnë sheqerin e humbur gjatë procesit të përpunimit të duhanit, me kusht që këto substanca shtesë shkaktojnë shije karakteristike dhe nuk rrisin në një nivel domethënës dhe të matshëm shkallën e varësisë, toksicitetit ose karakteristikave karcinogjene, mutagjene dhe toksicitetit për riprodhim të produktit të duhanit.	E plotë	Fjalja është përshtatur në një mënyrë që mund të kuptohet më lehtë në kontekstin e ligjit shqiptar. Kjo është arsyeja pse fjalia nuk përputhet me versionin anglisht të kur përkthehet nga anglishtja në shqip. Fjalja e fundit nuk është përkthyer pasi nuk është e aplikueshme në kontekstin shqiptar.
7 (2)	Komisioni, me kërkesë të Shteteve Anëtare ose me iniciativë të tij, përcakton me anë të akteve nënligjore nëse një produkt është brenda fokusit të paragrafit 1. Këto akte nënligjore duhet të jenë në përputhje me procedurat	Ligji “Per mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 6 paragrafi 2	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përcakton nëse një produkt duhani konsiderohet produkt duhani me shije karakteristike. Procedurat për këtë përcaktim vendosen me Vendim	E plotë	Paragrafi është përshtatur në mënyrë që të reflektojë institucionet shqiptare për procedurat

	ekzaminuese të referuara në Artikullin 25(2).			të Këshillit të Ministrave.		përkatëse.
7 (7)	Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intesitetin e tymit. Filtrat, letrat dhe kapsulat nuk duhet të përmbajnë duhan apo nikotinë.	Ligji “Për mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 6 paragrafi 7	Ndalohet vendosja në treg e produkteve të duhanit që përmbajnë aromatizues në secilin prej komponentëve si filtra, letra, paketime, kapsula apo çdo modifikim teknik që lejon modifikimin e aromës ose shijes së produktit të duhanit ose intesitetin e tymit. Filtrat, letrat dhe kapsulat nuk duhet të përmbajnë duhan apo nikotinë.	E plotë	
14 (1)	Njësitë e paketave të cigareve duhet të kenë formë kubike. Njësitë e paketave të duhanit për dredhje (kaush) do të kenë një formë kuboide ose cilindrike, ose formën e një qese. Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.”	Ligji “Për mbrojtjen e shendetit nga produktet e duhanit	Neni 6 paragrafi 2	Një njësi pakete cigare duhet të përmbajë të paktën 20 cigare. Një njësi pakete duhan për dredhje duhet të përmbajë jo më pak se 30 gram neto produkt duhani.”	E pjesshme	Për ligjin shqiptar u përdor një përmbledhje e shkurtuar e artikullit të direktivës në mënyrë që të jetë i thjeshtë dhe i lehtë për t’u kuptuar. Detaje të mëtejshme të artikullit rreth specifikimeve teknike nuk janë përdorur në ligj pasi janë të

						specifikuara në një pjesë tjetër të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit
7(14)	Në rastin e produkteve të duhanit me shije karakteristike, volumi i shitjes i të cilave në union është më shumë se 3% në një kategori të caktuar produkti, masat e këtij ligji hyjnë në fuqi prej 20 Maj 2020	Ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit	Neni 9	Ky projektligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”, me përjashtim të nenit 6 të këtij projektligji, paragrafi i parë i të cilit hyn në fuqi 48 muaj pas botimit në fletoren zyrtare dhe paragrafi i dytë i të cilit hyn në fuqi 24 muaj pas botimit në fletoren zyrtare.	E plotë	Neni 7(14) i direktivës indikon që kufizimet për produktet e duhanit me shije karakteristike të hyjnë në fuqi 48 muaj pas hyrjes në fuqi të direktivës, e cila ka hyrë në fuqi në 20 Maj 2006.